



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-00 35899-2/ dt. 03. 06. 2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 49 paragrafi 2, nënparagrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, nenin 40 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0035899/24, dt. 28.05.2024 të Drejtorisë së Inspektionit, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Vendimeve të Inspektoriatit të Ndërtimit)

1. **Formohet** Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Vendimeve të Inspektoriatit të Ndërtimit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Bedri Muja – (DI) kryesues;
 - 1.2 Mimoza Musa – (DGJKP) anëtare;
 - 1.3 Xhevdet Aruqaj – (DPU) anëtar.
2. Komisioni është përgjegjës që të shqyrtoj të gjitha ankesat e parashtruara ndaj Vendimeve të Inspektoriatit të Ndërtimit.
3. Gjatë shqyrtimit të ankesave Komisioni i lartcekur është i obliguar që të hartojë procesverbal, dhe për secilën ankesë duhet të marrë vendim për miratimin apo refuzimin e saj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, dhe e njëjta duhet ti dërgohet parashtruesit të ankesës. Komisioni obligohet që të hartoj Raport me Shkrim për ankesat e shqyrtuara dhe i njëjti, i dërgohet Kryetarit të Komunës përmes Drejtorisë së Inspektionit.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Ligjin Nr. 08/L-067 për Inspektimet, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.



5. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat 1 (një) vjeçar.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0035899/24, dt. 28 05 2024 të Drejtorisë së Inspeksionit

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë së Inspeksionit
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

